



PËRGJEGJËSIA SOCIALE

2024

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



Albsig dhe Albsig Jetë, një ditë ndryshe për fëmijët e qendrës ditore “Ngjyrat e Jetës” në Kavajë.

Fillimviti ka nisur me një eveniment të rëndësishëm në ndihmë të fëmijëve të qendrës Ditore “Ngjyrat e Jetës”, në Kavajë. Ka qenë Albsig Jetë ajo që ka mundur të organizojë një ditë ndryshe për fëmijët me aftësi ndryshe. Në Albsig, fëmijët kanë qenë dhe do të mbeten target grupi i shoqërisë që është suportuar në çdo kohë e çdo moment. Fëmijët janë e ardhmja dhe Albsig është gjithmonë përkrah të ardhmes. Për Albsig Jetë, ky janar ka startuar ndryshe. Kanë qenë fëmijët e Qendrës Ditore “Ngjyrat e Jetës” në Kavajë që janë mbështetur nga kjo e fundit.

Albsig Jetë përzgjedhi të jetë një ditë pranë fëmijëve të Qendrës Ditore “Ngjyrat e Jetës” Kavajë, e cila ofron mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke kontribuar sadopak në zhvillimin social nëpërmjet dhuratave simbolike që shërbejnë në aftësimin e tyre social dhe akademik. “Fëmijët janë gëzimi i jetës, të cilët kanë nevojë për shumë dashuri, si dhe të ndihen të sigurt për të ardhmen që i pret” u shprehën ekspertët e sigurimeve pjesmarrës në këtë eveniment shumë të rëndësishëm jo vetëm për prindërit e këtij komuniteti por për të gjithë qytetin e Kavajës. Kjo qendër i ka ardhur në ndihmë qytetit të Kavajës për të suportuar sadopak target grupin e fëmijëve me probleme të spektërve të ndryshme.

Jo vetëm kaq po kjo qendër ka realizuar një sërë programesh për t’ju ardhur në ndihmë familjeve të fëmijëve me probleme të tilla. Nisur nga kjo qendër dhe ky program që mbështet edhe edukatorët të cilat bëjnë të mundur zhvillimin socio-emocional të fëmijëve, janë të kënaqur edhe mbështetësit e tyre, në këtë rast Albsig, pasi u bë shkak që të kenë të paktën një ditë ndryshe nga e zakonshmja. Më pas punonjësit e Albsig Kavajë e specifikuan veçantinë e kësaj qendre, ishin vetë drejtuesit e Albsig që suportuan një ditë ndryshe për këta fëmijë. Albsig përmes pakove me mjete didaktike dhe dhurata të tjera bëri të mundur që fëmijëve të kësaj qendre t’ju krijojnë kushtet për të mundësuar sadopak mësimin në qendrën e tyre.






Stafi i grave dhe vajzave të Albsig vizitë turistike në Selanik me rastin e festës së 8 Marsit.

Festa e 8 Marsit ka mbledhur bashkë gjithë stafin e grave dhe vajzave të Albsig, Albsig Jetë, Albsig Invest në një fundjavë turistike në Selanik. Ka qenë dëshira e vetë stafit të grave dhe vajzave të Albsig që të bëjnë një tur të shkurtër në Selanik. Dhe kjo dëshirë është plotësuar menjëherë nga drejtuesit e kompanisë. I gjithë stafi i grave dhe vajzave të Albsig, Albsig Jetë dhe Albsig Invest janë organizuar pikërisht në fundjavën e festës së 8-marsit dhe kanë organizuar dhe turin e shkurtër për këtë sezon turistik. Nisja ka vijuar në mëngjes herët drejt pikës kufitare të Kapshticës. Ndalesat rrugës për pushimin e mëngjesit. Vazhdimi i rrugës drejt kufirit ka qenë shumë harmonik dhe i gëzuar mes këngëve e valleve mes kolektivit. Përfundimi i procedurave kufitare dhe doganore ka qenë pak me vonesa po sërish kjo gjë është suportuar mjaft mirë nga stafi i Albsig. Mbërritja në Selanik ishte rreth orës 17.00. Akomodimi nëpër dhoma, darka në hotel dhe koha e lirë për argëtim ka qenë e mbushur plot e për plot me vizita e shëtitje. Kthimi në hotel dhe darka.

Ka qenë një ndër turet më të mira të realizuar me të gjithë stafin e grave dhe vajzave të Albsig. Është e disata herë që stafi i grave dhe vajzave të Albsig me rastin e festës së 8 Marsit organizon ture të tilla. Ne, në Albsig besojmë se "Klienti është mbret" dhe "stafi është i shenjtë" për këtë edhe shërbimi i mirë vjen nga marrëdhëniet e forta që krijohen tek ekipi ynë, nga përkushtimi i çdo dite për të dhënë më të mirën dhe nga fryma e përfshirjes dhe solidaritetit me klientët. I gjithë stafi i Albsig që nga dita e parë e punës dhe gjatë gjithë viteve të përvojës, sfidojmë veten për të qenë gjithmonë në lartësinë e duhur, zhvillohemi për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të çdo klienti, sepse i konsiderojmë si partnerët tanë më të vlefshëm. Vlerat tona na bashkojnë e na bëjnë më të fortë për të përballuar çdo situatë.



Një ditë në Albsig, Iden pjesë e projektit “Drejtues për një ditë” nga Junior Achievement of Albania!

Në mbështetje të programit “Drejtues për një ditë” nga Junior Achievement of Albania, ishte me ne sot në Albsig, Iden, gjimnazistja nga Tirana, e cila sot ka qenë pjesë dhe ka drejtuar kompaninë për një ditë. E reja është njohur me të gjithë drejtuesit e kompanisë dhe njëkohësisht ka parë më nga afër të gjithë punën e departamenteve të shoqërisë.

Iden Nano, 18 vjeçarja ka qëndruar përgjatë një dite në Departamentin e Marketingut dhe ka parë më nga afër punën e këtij departamenti. **“E shikoj më afër marketingut veten time në të ardhmen”**, theksoi Iden në një bashkëbisedim me ekspertin e mediave në Albsig. Ajo shtoi se e shikon veten në një të ardhme të afërt si financiere ose marketiere të zonjën.

Shumë të lumtur të jemi pjesë e projektit “Drejtues për një ditë” nga Junior Achievement of Albania. Një ndër pikat ku të gjithë mund të pajtohemi është domosdoshmëria e edukimit joformal, punës praktike dhe vullnetarizmit. Mungesa e këtyre të trijave dhe përditshmëria e sistemit të edukimit shumë lehtë mbyt ambiciet në pothuajse çdo individ. Në një treg si ky i Shqipërisë ku mundësitë e zhvillimit nuk vijnë vetë, një i ri duhet të hapë rrugën dhe t'i gjejë vetë mundësitë, shpeshherë të fshehura. Dhe për të lehtësuar sadopak këtë rrugë Albsig synon krijimin e mundësive të reja për punësim dhe vetëpunësim të të rinjve të talentuar, nëpërmjet ndërthurjes së teknikave të hershme me elementë të rinj artistikë.



Së bashku, punojmë për një të ardhme më të shëndetshme!



Albsig bëhet pjesë e eventit “Java e Filantropisë 2024”

Albsig bëhet pjesë e eventit të zhvilluar nga PartnersAlbania në kuadër të Javës së Filantropisë për vitin 2024 NPO-Business Speed Dating. Për të 8-in vit radhazi është organizuar event i me titull **“Krijimi i Partneritetit Efektiv mes Shoqërisë Civile dhe Biznesit”**, ku këtë vit morën pjesë 70 biznese përfaqësues të sektorëve të ndryshme, si dhe OJF nga i gjithë vendi. Albsig ishte një nga bizneset pjesëmarrëse ku, në stendën e saj të prezantimit priti një numër të konsiderueshëm OJF dhe biznesesh pjesëmarrëse në këtë event. Sipas përfaqësuesve të Albsig, pjesëmarrës në event, kontakti me OJF-të ishte i mbushur me eksperiencë dhe informacione të reja mbi veprimtarinë e tyre të aktivitetit. Jo vetëm kaq, por Albsig gjithmonë është dhe do të jetë në mbështetje të iniciativave suportuese ndaj organizatave jofitimprurëse.

Ndryshe nga vitet e tjera ky eveniment ishte ideuar e dizajnuar në mënyrë të tillë për t’ju ardhur në ndihmë të gjithë bizneseve dhe OJF pjesëmarrëse në eveniment. Dhe jo vetëm kaq, por event i organizuar në përmbylljen e një serie aktivitetesh në kuadër të Javës së filantropisë pati edhe një konkurs pikturash ku aktivistë dhe të rinjë nga më shumë se pesë qytete prezantuan përmes artit tyre, konceptin e tyre mbi solidaritetin e filantropinë. Albsig ka qenë dhe do të mbetet një ndër promotorët dhe mbështetësit e startup-eve të reja. Numërohen me dhjetra biznese të vogla ku Albsig i ka mbështetur në fuqizimin e tyre.





“Java e parasë” Albsig, dhe Albsig invest ekspozitë me piktura nga fëmijët e stafit.

“Investo paratë, kultivo të ardhmen” kjo është tematika e ekspozitës për fëmijë, organizuar nga Albsig dhe Albsig Invest me rastin e eventit kushtuar “Javës së parasë”. Ky event kishte fokus perceptimin e fëmijëve pjesëmarrës mbi edukimin financiar. “Java e Parasë” është një aktivitet mbarëbotëror i parasë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë vendime financiare të mirëmenduara. Të gjitha shoqatat e bankave e sektori i financave përfshirë dhe partnerë të shumtë në mbarë globin, nën koordinimin e **Child and Youth Finance International (CYFI)** dhe të **Federatës Europiane të Bankave (EBF)**, organizojnë aktivitete të larmishme për t’i përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, për të mësuar: si të kujdesen për paratë, si të kursejnë, si të mendojnë financiarisht, si t’i kuptojnë ndryshimet në sistemet ekonomike ku jetojnë, si të fitojnë të ardhura nëpërmjet sipërmarrjes dhe të vendosin bazat për të ardhmen e tyre nëpërmjet kulturës financiare.

Qëllimi i Javës Ndërkombëtare të Parasë është që të fuqizojë gjeneratat e reja dhe të rrisë vetëdijen në lidhje me financat personale, kursimet, burimet e të ardhurave dhe dëshirën për të kursyer. Këtë vit do t’i jepet theks më i veçantë rëndësisë që edukimi financiar ka nga ana e institucioneve, informimi i publikut për rëndësinë e kursimeve dhe edukimit financiar, krijimi i një shoqërie me mirëqenie më të lartë që fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë që të pajisen me informacione të cilat ju shpërbejnë për të marrë vendime më të mira financiare. Ekspozita në Albsig, me pikturat e fëmijëve me tematikë: **“investo paratë, kultivo të ardhmen”** ishte ideuar e dezajnuar në mënyrë të tillë që të merrnin pjesë të gjithë fëmijët e punonjësve të stafeve të Albsig, Albsig Invest. Eventu realizuar për edukimin e fëmijëve mbi rëndësinë e parasë dhe mirëmenaxhimin e tyre, nxori në pah dhe talentin e të vegjëlve në pikturë.

Ekspozita e pikturës u realizua në sallën e madhe të Albsig ku fëmijët prezantuan punimet e tyre dhe dhanë një mesazh shumë të rëndësishëm mbi menaxhimin e parave në familje dhe rëndësinë e tyre. Por eventu u përmyll dhe me surpriza për fëmijët. Z. Elton Korbi, Drejtor i Përgjithshëm i Albsig Invest shpërndau certifikata për të gjithë pjesëmarrësit e ekspozitës, falenderoi prindërit që kanë ndihmuar fëmijët në këtë nismë të rëndësishme dhe premtoi që vitin e ardhshëm do të ketë më shumë aktivitete të tilla, ku në qendër do të jenë fëmijët.



Albsig, promotor në edicionin e 6 të Panairit Ndërkombëtarë të Turizmit!



Muaji prill ka startuar duke hapur siparin e panairove të shumta në kryeqytet. Një ndër to dhe jo më pak i rëndësishmi ishte Panairi Ndërkombëtarë i Turizmit i cili, ndryshe nga herët e tjera këtë edicion të gjashtë e ka realizuar në qendër të Tiranës në një nga sheshet më të frekuentuara nga konsumatorët, në Sheshin Italia. Në edicionin e 6-të të Panairit Ndërkombëtar të Turizmit, mori pjesë dhe Albsig, Albsig Invest dhe Tirana International Airport, ku përmes standave komunikuese, konsumatorët përfituan një prezantim ndryshe nga ana e kompanive pjesmarrëse.

Përveç standës më fletëpalosje me prezantime të shoqërive u përfitua nga ky rast për të ndarë me pjesëmarrësit një eksperiencë ndryshe. Komunikimi i drejtpërdrejtë me konsumatorët pjesmarrës në këtë eveniment ka qenë një ndër çështjet më të rëndësishme të eventit. Skema e fondit të pensionit privat ka qenë dhe çështja e diskutuar, ku Z. Elton Korbi, Drejtori Ekzekutiv i Albsig Invest, sqaroi avantazhet dhe sigurinë e këtij fondi, si një investim për veten dhe për familjen.



Albsig, pjesmarrëse në panairin e punës në Fakultetin e Ekonomisë.

Albsig gjithmonë do të jetë promotore dhe mbështetëse e studentëve. Këtë herë ka qenë sërish një ndër subjektet pjesëmarrëse në Panairin e Punës organizuar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, i cili vazhdon të mbetet një traditë shumëvjeçare e suksesshme. Tashmë e kthyer në një traditë të përvitshme Albsig është pjesë e pandashme e eventit të kthyer në një platformë shumë të mirë ndërlidhjeje për studentët me mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të karrierës, të ofruara nga mbi 60 kompani të mëdha të pranishme, përfshirë sektorët kryesorë të ekonomisë si konsulenca, bankat, sigurimet, prodhimi, teknologjia, telekomunikacioni, etj., Ceremonia e hapjes u organizua në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë me pjesëmarrjen e Prof. Dr. Artan Hoxha, Rektor i Universitetit të Tiranës, Z. Blendi Gonxhja, Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Z. Andi Seferi, Nënkryetar i Bashkisë së Tiranës dhe përfaqësues të bizneseve me fokusin e qartë për mbështetjen e studentëve përballë sfidave të punësimit.

Në fjalën e tij hapëse, Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Prof. Dr. Dhori Kule, shprehu kënaqësinë e tij për suksesin e panairit dhe vuri theksin në rëndësinë e bashkëpunimit midis akademisë, sipërmarrjes dhe institucioneve publike për krijimin e mundësive të zhvillimit të karrierës për studentët. Të ftuarit e nderit diskutuan mbi fokusin e nevojës për bashkëveprimin me biznesin, universitetet dhe pushtetin vendor e qendror për rritjen e kapacitetit të studentëve dhe punësimin e tyre. Gjithashtu përfaqësues të biznesit u shprehën optimistë për potencialin e studentëve të Fakultetit të Ekonomisë për të plotësuar nevojat e sipërmarrjes dhe për të sjellë inovacion në sektorët e tyre. Edhe Albsig si një ndër bizneset pjesmarrëse në panair mirëpriti studentët në stendën e saj indeuar për të rinjtë. Jo vetëm kaq, por ekspertët panë më nga afër kërkesën e madhe të studentëve për punë dhe për dije në fushën e sigurimeve.

Stenda e Albsig spikati me numrin e madh të vizitorëve. Albsig numëron shumë vite që është bërë pjesë mbështetëse dhe promotore e eventeve të ndryshme të zhvilluara nga fakulteti Ekonomisë. Panairi i Punës i Fakultetit të Ekonomisë, Universitetit të Tiranës, është një urë lidhëse për të gjithë ata që kërkojnë të ndërtojnë lidhje të reja, të zgjerojnë rrjetin e tyre profesional dhe të shfrytëzojnë mundësitë për të arritur sukses në karrierë. Kjo traditë vazhdon të jetë një shembull i bashkëpunimit dhe inovacionit në rrugën drejt një të ardhmeje më të ndritshme ekonomike dhe profesionale, si për studentët ashtu edhe për kompanitë pjesëmarrëse dhe dhanë një mesazh shumë të rëndësishëm mbi menaxhimin e parave në familje dhe rëndësinë e tyre. Por eventi u përmbyll dhe me surpriza për fëmijët. Z. Elton Korbi, Drejtor i Përgjithshëm i Albsig Invest shpërndau certifikata për të gjithë pjesëmarrësit e ekspozitës, falenderoi prindërit që kanë ndihmuar fëmijët në këtë nismë të rëndësishme dhe premtoi që vitin e ardhshëm do të ketë më shumë aktivitetete të tilla, ku në qendër do të jenë fëmijët.





Albsig, pjesë e panairit të organizuar nga Western Balkans University.

Western Balkans University, organizoi panairin në ndihmë të studentëve ku pjesëmarrëse në këtë event ishte dhe Albsig, pjesë e Kastrati Group. Studentët e WBU shprehën se këto mundësi intershipi i ndihmojnë ata të integrohen në punësim në të ardhmen. Stenda e Albsig ishte një ndër stendat më të frekuentuara nga të rinjtë. "Panairi i Karrierës është një mundësi është diçka shumë e vlefshme për të gjithë studentët, pasi të gjithë ne e kemi pikëpyetjen e madhe se çfarë do të bëjmë pasi të mbarojmë studimet tona. Por, mendoj që sot është një ide e mirë për të nisur pse jo intershipet e më pas më vendet tona të punës në të ardhmen", u shpreh një student që vizitoi stendën e Albsig.

Stenda e Albsig, së bashku me ekspertët e kompanisë, pjesëmarrëse në event ju erdhi në ndihmë studentëve për t'i orientuar ata drejt mundësive të reja. "Sot është një mundësi e mirë integrimi prej studentëve dhe tregut të punës dhe bizneseve të tjera për qark. Për momentin kam aplikuar në disa stenda që i përkasin fushës time", u shpreh një tjetër student visitor në stendën e Albsig.

Universiteti "Western Balkans" është i vetmi universitet në Shqipëri, i cili siguron për studentët praktika të paguara që në vitin e parë të studimeve në kompanitë më të mëdha brenda dhe jashtë vendit dhe siguron punësim të sigurtë pas studimeve.




Mbi 35 biznese dhe institucione morën pjesë në Panairin e Karrierës të organizuar nga Universiteti Western Balkans në Bashkëpunim me Dhomën Britanike të Tregtisë në Shqipëri. Ky panair ishte një mundësi e mirë për studentët për të njohur dhe parë nga afër mundësitë e shumta të praktikave, intershipeve dhe punësimit që kompanitë ofrojnë.

Në Panairin e Karrierës krahas shumë të ftuarve ishin të pranishëm edhe Znj. Ermonela Felaj, zv. Kryetare e Parlamentit të Shqipërisë, Z. Nathan Dann, përfaqësues i ambasadës britanike në Shqipëri, Znj. Jonida Lakuriqi, zv. Kryetare e Dhomës Britanike të Tregtisë, Znj. Keti Luarasi, nënkryetare e Bashkisë Tiranë, Z. Elton Korbi, Drejtor Ekzekutiv i Albsig Invest, etj.

Panairi u hap me fjalën përshëndesë të Presidentit të Universitetit Western Balkans Prof. Dr. Ferdinand Gjani, i cili tha se ky aktivitet thekson edhe njëherë përkushtimin që WBU ka për t'u krijuar mundësi të ndryshme studentëve që të kenë një punësim të sigurt gjatë dhe pas studimeve.

Panairin e përshëndetën edhe Znj. Ermonela Felaj, zv. Kryetare e Parlamentit të Shqipërisë, Z. Nathan Dann, përfaqësues i ambasadës britanike në Shqipëri, Znj. Jonida Lakuriqi, Zv. Kryetare e Dhomës Britanike të Tregtisë dhe Znj. Keti Luarasi, nënkryetare e Bashkisë Tiranë. Universiteti Western Balkans është i vetmi universitet në Shqipëri i cili siguron për studentët praktika të paguara që në vitin e parë të studimeve në kompanitë më të mëdha brenda dhe jashtë vendit dhe u siguron punësim të sigurt atyre pas studimeve.





 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL